



KUVENDI I KOMUNËS  
KOMITETI PËR POL. DHE FIN.  
01.Nr. 06-1945  
KLINË, 13.2.2017

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

### I SEANCËS SË II TE KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA, MBAJTUR MË 13.2.2017, NË ORËN 10.00, NË SALLËN E KUVENDIT TË KOMUNËS SË KLINËS

Në seancë prezantuan: Kryesuesi i KK. Dr. Haxhi Ibishi, anëtarët e KPF-së, drejtorë të drejtorive, Zyra Ligjore, OSBF, Zyra e Auditimit, Zyra për Integritim Europian, OJQ "Koha", Zyra e Informimit etj.

Seancën e udhëhoqi kryesuesi i KK, Dr. haxhi Ibishi, i cili fillimisht ju uroj mirëseardhje për pjesëmarrje në këtë seancë të KPF-së. Kryesuesi Ibishi prezantoi një kërkese të Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport, për përfshirjen në rend të ditës për subvencionimin e klubeve të komunës së Klinës.

Kryesuesi vuri në propozim rendin e ditës me plotësim rreth kërkesës së DKRS, rreth subvencionimit të klubeve të komunës së Klinës.

Me vota unanime u miratua ky

## REND I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi i Draft-rregullores komunale për Menaxhimin e Mbeturinave,
4. Shqyrtimi i Draft-planit komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2017-2021,
5. Shqyrtimi i Draft-planit të Integritetit 2017-2019,
6. Shqyrtimi i Raportit Komunal të Menaxhimit Financiar për periudhën janar-dhjetor 2016,
7. Shqyrtimi i Planit të Prokurimit për vitin 2017,
8. Shqyrtimi i propozimit për iniciimin e procedurës për vënien në diskutim publik të Ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe taksa

9. Shqyrtimi i procesverbalit të Takimit të Kryetarit me qytetarë, të dt.29.12.2016,
10. Inicimi i procedurës për hartimin e hartave zonale,
11. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS rreth subvencionimit të klubeve sportive,
12. Të ndryshme.

**Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.**

Kryesuesi sqaroi se nuk ka mungesa nga ana e anëtarëve.

**Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.**

Kryesuesi hapi diskutimin rreth procesverbalit të seancës së kaluar.

**Halil Desku**, pati vërejtje në deformimin e diskutimit të tij, ku sipas tij që ka qenë me siguri gabim teknik. “Te shprehja: “jon te ekzekutivi”, duhet të jetë “jo te ekzekutivi”. Janë gjera me rëndësi, prandaj duhet përmirësuar në procesverbal”, shtoi prof. Desku.

**Pika e tretë: Shqyrtimi i Draft-rregullores komunale për Menaxhimin e Mbeturinave.**

Kryesuesi foli rreth çështjes në rend të ditës.

**Ramush Agushi**, kërkoi sqarim, se a duhet votuar apo rekomanduar.

Kryesuesi sqaroi se duhet rekomanduar. Kryesuesi fjalën e barti për raportim te Drejtori i SHBE, z. Gjokë Lleshaj,

**Gjokë Lleshaj**, raportoi rreth Draft-rregullores komunale për Menaxhimin e Mbeturinave dhe kërkoi që të procedohet për procedim në seancën e KK-së.

**Pal Berisha**, tha se te neni 5, pika 5.8 shkruan: (Lexoi nenin), fjala “autorizon”, do të kishte qenë mirë që të zëvendësohet me shprehjen “obligon” ose “kërkon”. Anëtari Berisha e arsyetoi propozimin dhe vazhdoi: “Pikën 11.2. nuk e kam të qartë. (lexoi pikën 11.2). Shqetësimin e kam, pse të gjobiten qytetarët nëse kushtet për shpërndarje të mbeturinave nuk janë krijuar. Kujt i referohet neni 11.2?,- shprehu interesimin anëtari Berisha.

**Gjokë Lleshaj**, iu përgjigje interesimeve të anëtarit Berisha.

**Fadil Gashi**, tha se jemi të hendikepuar për të diskutuar rreth çështjes në shqyrtim. “ A janë implementuar ato vërejtje që janë dhënë në këtë draft-rregullore. Nëse hymë në debat, është çështje tjetër, megjithatë e vlerësoj për ta rekomanduar për seancë të KK-së. Nuk jam i përgatitur për të diskutuar rreth këtij draft-plani”, tha anëtari Gashi.

Kryesuesi Ibishi, propozoi që drafti-plani të rekomandohet për procedim në KK.

Vuri në miratim rekomandimin.

**Me vota unanime u rekomandua propozimi për procedim në KK.**

**Pika e katërt: Shqyrtimi i Draft-planit komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2017-2021.**

Kryesuesi hapi diskutimin rreth draft-planit. Nuk pati diskutime.

Kryesuesi vuri në miratim rekomandimin për procedim në seancën e KK\_së.

**Me vota unanime u miratua propozimi për rekomandim të draft-planit për KK.**

**Pika e pestë: Shqyrtimi i draft-planit të Integritetit.**

Kryesuesi hapi diskutimin. Nuk pati diskutime. Kryesuesi vuri në miratim propozimin për rekomandim në KK.

**Me vota unanime u miratua rekomandimi.**

**Pika e gjashtë: Shqyrtimi i Raportit Komunal të Menaxhimit Financiar për periudhën janar-dhjetor 2016,**

**Kryesuesi Ibishi,** fjalën e barti për raportim te drejtori i Drejtorisë për FEZH, z. Ramiz Rrusta.

**Ramiz Rrusta,** në mënyrë kronologjike foli rreth Raportit Komunal të Menaxhimit Financiar për periudhën janar - dhjetor 2016.

Fillimisht drejtori Rrusta adresoi vërejtje rreth OJQ “Koha” për prezantimin e të dhënave të raportit në disa portale dhe mjete të informimit publik.

“I kemi parë disa të dhëna, disa shënime nëpër portale dhe mjete tjera të informimit se kanë dalë para se të dalim në zyrtarisht. Mendojmë që ky veprim është jo korrekt. Ne së pari raportojmë në KPF pastaj edhe në KK dhe i prezantojmë të dhënat tona të sakta. Nuk bëhet shërbim të dilet në këtë mënyrë, po që se vazhdohet në këtë mënyrë ne do të ndërpresim komunikimin dhe bashkëpunimin. Ne gjithëherë kemi qenë të gatshëm që për çdo interesim të jemi transparent dhe ju kemi ofruar të dhënat tona, prandaj nuk do të ishte korrektësi ky keqpërdorim të ndodh”, shtoi drejtori Rrusta, i cili në vazhdim në mënyrë kronologjike foli rreth pasqyrës së shpenzimeve financiare janar-dhjetor 2016, të cilat të dhëna janë në mënyrën më të specifikuar në Raportin komunal të Menaxhimit Financiar për periudhën janar – dhjetor 2016.

**Kryesuesi Ibishi,** hapi diskutimin rreth Raportit Komunal të Menaxhimit Financiar për periudhën janar - dhjetor 2016.

**Fadil Gashi,** tha se më bëri përshtypje reagimi i drejtorit rreth organizatave joqeveritare. “Po që se ata kanë dalë me shifra të sakta, atëherë nuk ka asgjë të keqe. Nëse janë dhënë ato para për veturë, është mirë për të ditur të gjithë, a janë dhënë apo nuk janë dhënë. Edhe nëse ka

keqpërdorime, është mirë për të ditur. Vetura nuk është. Të sqarohet, të mos merren portalet as askush. Çështja e veturës të sqarohet. Pjesa tjetër, po dilet që dukshëm janë zvogëluar shpenzimet, a është punuar apo jo. Shpenzimet te kategoria e karburanteve të veturave prej mbi 89 mijë euro kanë rënë në 40 mijë euro, domethënë janë përgjysmuar. A ka qenë ekzekutivi duke paguar haraç për fushatën e kaluar, ndërsa tash kemi hyrë në një vit normal. Te Drejtoria e Shëndetësisë mospërfillja mund të jetë gabim teknik (sqaroi mospërfilljen). Po e lëmë për të proceduar në seancën e radhës së KK”, shtoi anëtari Gashi.

**Skënder Merturi**, tha se nuk po pajtohem me vërejtjet që iu adresuan OJQ “Koha”. “OJQ “Koha”, po e përcjellë punën shumë mirë. Është e drejtë e tyre për të dalë qysh kanë dalë. Është e vetmja OJQ që punën e saj e kryen shumë mirë. Vazhdimisht kam kritikuar veturën e Kryetarit dhe tash po shihet se na ka kushtuar shtrenjtë. Ka ulje të shpenzimeve te disa kategori, vërejtja ime është rreth gjobave të gjykatës, a do të ketë edhe në këtë vit gjoba të gjykatës? Krijimi i këtyre pagesave te shpenzimeve të gjobave është përgjegjësi e ekzekutivit”, pohoi anëtari Merturi.

**Ndue Shabanaj**, tha se e kemi dhënë kontributin tonë në raportet financiare, sepse i kemi shqyrtuar në çdo tre muaj. “Është e mirë që janë ulur shpenzimet. “Nga “Koha” askush nuk është kundër informimit, mirëpo informimi i parakohshëm nuk shërben për të mirë. Domethënë OJQ-të bëjnë garën për informim të parakohshëm. Është kodi i respektit. Është dashur të dal me konstatime një organ institucional. Nuk jemi kundër, por ka ngarendje të një ndjenje jo të këndshme”, shtoi prof. Shabanaj.

**Halil Desku**, tha se po të isha unë kryetar dhe të më kishte ndodhë ashtu, do të kishte qenë skandaloze. “Dua të shoh një OJQ qytetare, e jo OJQ të partive politike, përkatësisht të subjektit politik, VV”, tha prof. Desku.

**Skënder Merturi**, tha se OJQ “Koha” nuk është e VV, por në shërbim të qytetarëve. “Nuk është material ilegal. Këta kanë të drejt të dalin me të dhëna të tilla po që se janë të konfirmuara”, tha anëtari Merturi.

**Fadil Gashi**, tha se si tepër u morët më këtë çështje. “Nuk kemi nevojë për t’u marrë kaq shumë. Ka raportuar raportet që i kemi shqyrtuar. S’ka pasqyruar asgjë që nuk është. Komuna ka të lidhur memorandimun me OJQ “Koha””, shtoi anëtari Gashi.

**Ramiz Rrusta**, tha se është nënshkruar një memorandum me Kryetarin. “Ju kemi ofruar çdo dokument. Të mos dalin me shënime pa dalë në me të dhëna të saktësuara. Asnjë shpenzim nuk mund t’ju prezantojmë pa u paguar veturat. Jemi për bashkëpunim. Nuk qëndron konstatimi që paguar haraç të zgjedhjeve. Gjobat nga gjykatat, qëndron. Lënda është në proces të shqyrtimit. I kemi bërë ankesat. Secili jep llogari për atë që punon dhe nënshkruan. Në vazhdim drejtori Rrusta, raportoi rreth të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2016. “Për të analizuar realizimin e buxhetit për periudhën janar-dhjetor 2016, do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore; do të realizojmë disa trende të këtyre të hyrave buxhetore, si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetorë për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Siç shihet, ka vazhduar drejtori Rrusta, buxheti sipas SIMFK për janar – dhjetor 2016 është më i

vogël për rreth 0.17 për qind se buxheti për periudhën e njëjtë të vitit 2015. Buxheti i shpenzuar për periudhën janar – dhjetor 2016 në vlerë 8,376,332.94 euro, është 94.11 për qind e buxhetit në SIMFK për 2016. Nga Granti qeveritar janë shpenzuar 7,511,739.25 euro (99.95 për qind në raport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat vetanake janë shpenzuar 522,829.15 euro (50.85 për qind në raport me buxhetin nga të hyrat për vitin 2016), nga të hyrat e bartura janë shpenzuar 196,118.63 euro (94.97 për qind, në raport me buxhetin nga të hyrat e bartura), nga participimet e qytetarëve janë shpenzuar 31,362.00 euro (85.96 për qind në raport me mjetet e participimit të qytetarëve) etj. Prandaj, krahasuar me vitin paraprak në vitin 2016, në vitin 2016 shpenzimet në total në vlerë 8,376,332.94 euro, janë më të vogla për 2.7 për qind se shpenzimet e vitit 2015, që ishin 8,611,908,24 për qind. Nga buxheti i shpenzuar në këtë periudhë, nga kjo shumë për paga e mëditje janë shpenzuar 5,674,867.65 euro (74.75 për qind e shpenzimeve), për mallra dhe shërbime 606,417.19 euro (7.24 për qind e shpenzimeve), për shërbime komunale 161,095.48 euro (1.92 e shpenzimeve), për subvencione 61,655.63 euro (0.74 për qind e shpenzimeve) dhe për kapitale 1,872,296.99 euro (22.35 për qind e shpenzimeve), dhe për kapitale 1,872,296.99 euro (22.35 për qind e shpenzimeve). Shpenzimet në periudhën janar – dhjetor 2016 në vlerë 8,376,332.94 euro, krahasuar për periudhën e njëjtë të vitit 2015 në vlerë prej 8,611, janë zvogëluar rreth 2.74 për qind. Shpenzimet për paga dhe mëditje janë rritur 1.87 për qind, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë zvogëluar për 22.45 për qind dhe shpenzimet për kapitale janë zvogëluar për 13.76 për qind”, ka shtuar drejtori Rusta, i cili në vijim ka folur edhe për të hyrat e realizuara në periudhën janar-dhjetor 2016 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak; shpenzimet buxhetore për periudhën janar-dhjetor 2016 dhe ndryshimi me vitin 2015, ku sipas drejtorit Rusta, ka zvogëlime në shumë kategori buxhetore; etj. “Është raport real dhe i arsyeshëm”, ka konstatuar drejtori Rusta.

**Haxhi Ibishi**, tha se askush nuk ka asgjë kundër OJQ-së, kërkesa e drejtorit ishte për një informim racional.

Kryesuesi vuri në miratim rekomandimin për ta proceduar raportin e menaxhimit financiar janar- dhjetor 2016, në seancë të KK-së.

**Me vota unanime u rekomandua propozimi.**

**Pika e shtatë: Shqyrtimi i Planit të Prokurimit për vitin 2017.**

Kryesuesi foli rreth Planit të Prokurimit për vitin 2017. Fjalën e barti te Abaz Foniqi, zyrtar i lartë i Prokurimit.

**Abaz Foniqi**, raportoi rreth Planit të Prokurimit për vitin 2017.

“ Është vetëm bartje që përcjellën në Agjencionin Gjeneral të Prokurimit në Prishtinë. Janë kërkesat e drejtorive komunale. Projektet mund të ndryshojnë. Projektet kapitale janë ato që janë Paraparë”, theksoi zyrtari Foniqi, i cili tha se po që se ndonjëri ka ndonjë interesim rreth çështjes në shqyrtim është i gatshëm të jap sqarime.

**Ndue Shabanaj**, tha se e kam ngrehur, edhe kësaj radhe po e ngre një vërejtje për formën e komunikimit zyrtar. “Materiali është me shumë gabime gjuhësore, që është e patolerueshme

të qëndrojnë si dokument zyrtar. Mendoj që është më se e domosdoshme të korrigojen shkresat zyrtare”, theksoi prof. Shabanaj.

Kryesuesi vuri në miratim rekomandimin që Plani i Prokurimit për vitin 2017 të procedohet në AK.

**Me vota unanime u miratua propozimi për rekomandim në KK.**

**Pika e tetë: Shqyrtimi i propozimit për iniciimin e procedurës për vënien në diskutim publik të Ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe taksa Komunale, dhjetor 2014.**

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes në rend të ditës. “Është inicim, duhet shkuar në debatin me publikun. Vuri në miratim rekomandimin.

**Me vota unanime u miratua rekomandimi.**

**Pika e nëntë: Shqyrtimi i procesverbalit të Takimit të Kryetarit me qytetarë, të dt.29.12.2016.**

Kryesuesi, Dr. Ibishi, foli rreth procesverbalit të Takimit të Kryetarit me qytetarë, të dt. 29.12.2016.

Nuk pati debate.

**Pika e dhjetë: Inicimi për hartimin e hartave zonale.**

Kryesuesi fjalën për sqarim e barti te z. Baki Gashi, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm.

**Baki Gashi**, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, sqaroi për hartat zonale në Komunën e Klinës. “Hartimi i hartave zonale janë obligim. Ne jemi të gatshëm me hartimin e hartave zonale me të gjitha drejtoritë tjera. Do të zgjasin 15 muaj. Hartat zonale kanë vlefshmërinë në kohëzgjatje prej 8 vitesh”, sqaroi drejtori Gashi.

**Fadil Gashi**, tha se ku ekziston dallimi në mes të hartave zonale dhe Planit Detal të Urbanizmit dhe a kemi mjete për të implementuar këtë projekt të hartimit të hartave zonale.

**Baki Gashi**, sqaroi interesimin e anëtarit Gashi. Drejtori Gashi tha se ky plan i hartave zonale zëvendëson edhe Planin Zhvillimit, por edhe Planin Detal. I kemi paraparë 100 mijë euro, këtë vit kemi në shfrytëzim 50 mijë euro. Do të përfshijmë gjithë territorin e Komunës së Klinës”, sqaroi drejtori Gashi.

Kryesuesi vuri në miratim rekomandimin për të proceduar në AK.

**U miratua rekomandimi për procedim në KK.**

**Pika e njëmbëdhjetë: Shqyrtimi i kërkesës së DKRS rreth subvencionimit të klubeve sportive.**

Kryesuesi fjalën e barti te drejtoresha e DKRS, znj. Kristina Lazri.

**Kristina Lazri**, drejtoreshë e DKRS, foli rreth kërkesës. Arsyetoi vonesën e kërkesës për ta prezantuar për shqyrtim në KPF.

“Nuk kemi caktuar shumë. Sivjet kemi kërkesa të shumta për subvencionim të klubeve, pasi që klubet janë shtuar. 90 mijë euro kanë kërkuar. Këtë vit kam 50 mijë euro. Kisha kërkuar që kërkesës t’ia japim vizën për në AK dhe të shqyrtohen kërkesat e secilit klub sportiv”, shtoi drejtoresha Lazri.

**Haxhi Ibishi**, foli rreth çështjes në shqyrtim. “Në KK drejtorja le t’i shqyrtojë kërkesat e secilit klub dhe të dalë me arsyeshmërinë e shpenzimeve. Janë rritë klubet sportive në komunën tonë. Të na sjellën propozimet konkrete, pastaj ne t’i shqyrtojmë për secilin klub veç e veç”, pohoi Kryesuesi.

**Fadil Gashi**, foli rreth çështjes në shqyrtim. “Po pajtoj. Kërkesa është ardhur e detajizuar. Po propozoj, për seancën e radhës të KK të bëhet propozim-vendimi për secilin klub dhe ne i shqyrtojmë. Federata merr mjete. Është mirë që klubet tona me hulumtuar burimet financiare të Federatës”, theksoi anëtari Gashi.

**Kristina Lazri**, tha se mbështetje nga ana e Federatës është tepër e vogël. “Vijmë me një vendim për një ndarje në mënyrë që të mos i hymë në hak askujt”, tha drejtoresha Lazri.

**Ramush Agushi**, tha se falënderoj klubet sportive për projektet e përgatitura. “Është hera e parë që vijnë me projekte të tilla, që na shërbejnë për të na çelur rrugën. T’u ndihmojmë për aq sa kemi mundësi. T’i vlerësojmë prioritetet. Të dimë cila kërkesë është me prioritet. Rinia jonë është e nevojshme të ndihmohet”, shtoi anëtari Agushi.

Kryesuesi vuri në miratim rekomandimin për të proceduar në KK.

**Me vota unanime u miratua rekomandimi.**

Kryesuesi falënderoi për kontributin e dhënë.

Mbledhjen e konstatoi të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15 minuta.

Procesmbajtësi,  
Mikel GOJANI

